



**KONTRATE PER BLERJE AKSIONESH**

Sot me daten 20/11 2005 (dymije e pese), ditën e martë në Dhomen e Noterise Tirane para meje Noteres Publike Eriketa KOKOLI, ndermjet:

- a) **Shoqeria tregtare "EURO ALBA EA" SH.P.K.**, krijuar si person juridik me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 8724, date 20.12.1993, perfaqesuar ketu nga Ortaku i Vetem **Z. Kadri Morinaj**, i biri i Tahirit, lindur me 09.02.1964 ne Kukës, dhe banues ne Tirane ne Rrugen "Mihal Grameno", Nr. 196, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr. Z 0590894, (ne vazhdim i quajtur "Shitesi").
- b) **Z. Faik Bruçi**, i biri i Ramadanit, lindur me 01.01.1956 ne Diber, banues ne Rrugen "Qemal Stafa", Pall. i Ri 12 KT, Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr. Z 0318284, (ne vazhdim i quajtur "Bleresi").

Eshte rene dakort sa me poshte vijon:

1. **Shitesi** ka te drejten e plote dhe ekskluzive te pronesise e posedimit te katerqind e dyzet (440) aksioneve te regjistruara me nje vlere nominale prej njeqind mije (100.000) LEKE secili. Keto aksione perfaqesojne 4,16 % te kapitalit te aksionereve te shoqerise anonime "BANKA POPULLORE" Sh.a, shoqeri qe eshte themeluar dhe qe vepron sipas Legjislacionit Shqiptar, me Vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane Nr. 30724 date 12.12.2003 dhe ne baze te Licenses se Veprimit Nr. 17, date 16.02.2004 leshuar nga Banka e Shqiperise.
2. **Shitesi** i shet, transferon e dorezon pronesine dhe posedimin e plote te nje pjese te aksioneve te siperpermendura, dhe me sakte te dyqind e njezet (220) aksioneve te regjistruara me nje vlere nominale prej njeqind mije (100.000) LEKE secili, qe perfaqesojne 2,08 % te kapitalit aksioner te shoqerise anonime "BANKA POPULLORE" Sh.a., me te gjitha te drejtat qe rrjedhin prej tyre, **Bleresit** i cili e pranon kete blerje kundrejt çmimit njezet e dy milione (22.000.000) LEKE. Ky çmim i korrespondon vleres nominale te aksioneve qe blihen. Palet kontraktuese do te proçedojne njekohesisht ne regjistrimin e duhur te ketij transaksioni si ne Librin e Aksioneve, ashtu dhe ne Librin e Aksionereve te "BANKES POPULLORE" Sh.a.
3. **Bleresi** ia ka paguar plotesisht **Shitesit** çmimin prej njezet e dy milione (22.000.000) LEKE.
4. **Shitesi** deklaron se aksionet transferohen te lira dhe te pastra nga çdo peng, barre ose detyrim tjetër ligjor, ose ndonje difekt aktual ose ligjor ne pergjithesi.
5. Palet bien dakort qe **Shitesi** nuk ka asnje te drejte tjetër ndaj **Bleresit** ne lidhje me blerjen e ketyre aksioneve.

6. Pas transferimit te aksioneve, **Shitesi** nuk ka asnje te drejte ose titull mbi keto aksione dhe **Bleresi** te cilit i jane transferuar dhe dorezuar aksionet ne kushtet e pronesis dhe posedimit te plote, ka te drejte ti zoteroje, posedoje, perdore, shfrytetoje dhe rregulloje ato sipas vullnetit te tij te lire si pronar dhe posedues i tyre. **Bleresi** ka te drejte te ushtroje te tera te drejtat qe rrjedhin nga e drejta e tij e pronesis dhe ai do te marre nga "BANKA POPULLORE" Sh.a. certifikatat perfundimtare te aksioneve kur ato te leshohen.
7. Çdo mosmarreshje qe do te linde ne lidhje me ekzekutimin ose interpretimin e kesaj kontrate do te shqyrtohet nga Gjykata kompetente e Tiranës.
8. Palet kontraktuese deklarojne se heqin dore nga e drejta per ta apeluar dhe per ta revokuar (shfuqizuar) kete kontrate.

Ne deshmi te sa me siper, kjo kontrate hartohet ne tre origjinale, nga te cilat nga nje kopje u jepet paleve dhe kopja e trete mbahet nga Noteri Publik, dhe konform vullnetit te lire te paleve, te cilet pasi e lexuan e me ze te larte dhe mbasi u kuptua nga Palet u nenshkrua rregullisht prej tyre para Noterit.


### PALET KONTRAKTUESE

**SHITESI**

Shoqeria Tregtare

"EURO ALBA EA" Sh.p.k.

Ortaku i Vetem



**NOTERI**

**BLERESI**

Two handwritten signatures in cursive script are written in the space designated for the buyer. The signatures are written in black ink and appear to be the names of the buyer.

PULLE TAKSE

100  
LEKE  
RISHQIPERISE